

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Z.Illir Adili dhe Z.Muharrem Kokona, Ortake te

Shoqerise AK-INVEST sh.a Tirane

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te shoqerise **AK-INVEST sh.a.**, te cilat perbehen nga Bilanci Kontabel i dates 31.12.2010, pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyren e flukseve te parave dhe Pasqyra e levizjeve te kapitaleve te veta per ushtrimin e mbyllur ne ate date, si dhe nje permbledhje e metodave te rendesishme kontabel dhe shenimeve te tjera anekse.

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Raportimit Financiar. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel; dhe kryerjen e cmuarjeve kontabel te arsyeshme per rrethanat.

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion per keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone. Auditimi yne u krye ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto Standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat e etikës dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellim qe te marrim nje siguri te arsyeshme nese pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale .

Auditimi ka te beje me kryerjen e procedurave per te marre evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, perfshire ketu vleresimin e rreziqeve te anomalive materiale ne pasqyrat financiare, si pasoje e mashtrimit apo e gabimit. Kur vlereson keto rreziqe, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem te entitetit mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare ne menyre qe te planifikoje procedura te pershtatshme auditimi ne rrethanat perkatese te entitetit, por jo per qellim qe te shprehe nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Auditimi gjithashtu ka te beje me vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe me vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidencia e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat per opinionin tone te auditimit:

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare japin nje pamje te vertete e te sinqerte per gjendjen financiare te shoqerise " AK-INVEST " sh.a ne date 31 Dhjetor 2010 dhe te rezultatit te saj financiar per vitin e mbyllur ne ate date, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit

Eksperte Kontabel te Regjistruar

Tirane, me 24.03.2011

Ludmilla Paluka

Rruga e Muhamet Gjollës
Pallati 43/1 ap 9, Tirane
Nr. Kontakti Cel.0692036339

LUDMILLA MONE PALUKA
E.K.A LIÇENS NR 161
C.FISK K71616038S